



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 107

Tiranë – E martë, 18 korrik 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 117, datë 11.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11083
Dekret i Presidentit nr. 118, datë 11.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11083
Dekret i Presidentit nr. 119, datë 11.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11083
Dekret i Presidentit nr. 120, datë 11.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11083
Dekret i Presidentit nr. 121, datë 11.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11084
Dekret i Presidentit nr. 122, datë 11.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 11084
Dekret i Presidentit nr. 123, datë 11.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11084
Dekret i Presidentit nr. 124, datë 11.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11085
Dekret i Presidentit nr. 137, datë 12.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 11085
Dekret i Presidentit nr. 138, datë 12.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 11085
Dekret i Presidentit nr. 139, datë 12.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 11086

Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 97, datë 13.7.2023	Për delegimin e kompetencave.....	11086
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 412, datë 11.7.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Lituania.....	11086
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 413, datë 11.7.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Greqia.....	11089
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 414, datë 11.7.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Bosnjë-Hercegovina.....	11091
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 415, datë 11.7.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Kroacia.....	11093
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 416, datë 12.7.2023	Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Maqedonia e Veriut.....	11095
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 447, datë 11.7.2023	Për delegim kompetencash.....	11098
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 194, datë 19.6.2023	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	11098
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 195, datë 19.6.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “EU Green Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	11100
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 196, datë 19.6.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	11101
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 197, datë 19.6.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	11102
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 198, datë 19.6.2023	Mbi shtyrjen e afatit të parashikuar në kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.....	11103
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 207, datë 27.6.2023	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63, datë 8.4.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Gega-G’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Prevall’ me kapacitet të instaluar 1750 kw”.....	11104

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 210, datë 27.6.2023	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 249, datë 13.12.2021, i ndryshuar, në lidhje me plotësimin e kushteve të licencimit nga shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k.....	11106
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 211, datë 27.6.2023	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 250, datë 13.12.2021, të ndryshuar, në lidhje me plotësimin e kushteve të licencimit nga shoqëria “SOT-AL” sh.p.k.....	11107

**DEKRET****Nr. 117, datë 11.7.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, si dhe nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Shkëlzen Agim Nasimi
2. Adelina Mustafë Loxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 118, datë 11.7.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Fatlinda Naim Elezkurta
2. Egzon Ismet Nezaj
3. Anesa Ramë Syla
4. Elvis Skender Lushaj
5. Përparim Zeqir Pnishi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 119, datë 11.7.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93, të Kushtetutës, nenit 6, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Januz Urim Bytyqi
2. Janina Urim Bytyqi Miftari
3. Lamone Bajram Bytyqi
4. Albana Rrahman Nuredini (Shala)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 120, datë 11.7.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93, të Kushtetutës, nenit 6, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënie e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Enis Tahir Myrta
2. Bekim Ibrahim Kryeziu
3. Valbona Deli Osmanollaj (Guci)
4. Ermedina Gzim Amza
5. Shkodran Naser Hashani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 121, datë 11.7.2023

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93, të Kushtetutës, nenit 6, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënie e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Man Zeqir Fanaj
2. Shemsidin Sadik Ademaj
3. Jeton Sahit Buqa
4. Arben Nexhmedin Kadriaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 122, datë 11.7.2023

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93, të Kushtetutës, nenit 13, nenit 14, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit të mëposhtëm:
David Artan Shkëmbi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 123, datë 11.7.2023

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93, të Kushtetutës, nenit 6, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënie e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Hekuran Rustem Kameri
2. Arbresha Ismet Nezaj
3. Astrit Shumzim Micaj
4. Femije Ibish Kabashi (Ademaj)
5. Përparim Selahudin Tara



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 124, datë 11.7.2023

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, si dhe nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënie e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Agim Mehmed Pulaj
2. Liridon Ramë Sylaj
3. Sabiha Jashar Dida (Kallabak)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 137, datë 12.7.2023

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Admir Zamir Agia
2. Aleksandër Pavlo Kosirçani
3. Laureta Hasan Hallulli
4. Dejan Viktor Jojiç
5. Ines Kristaq Mitro

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 138, datë 12.7.2023

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë” me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Natasha Peko Pelçiq (Hajkoja)
2. Alma Gëzim Manuka
3. Rey Sumaila Mamudo Sanha
4. Ervis Isuf Lilaj
5. Besmira Rexhep Kolla
6. Denisa Gëzim Papa
7. Emi Ferdinand Godo

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 139, datë 12.7.2023****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, nenit 14, si dhe nenit 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë” me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Agim Rustem Cani
2. Oselito Arben Refati
3. Kroi Oselito Refati
4. Egert Mehmet Ymeraj
5. Noah Egert Ymeraj
6. Deivi Robert Konomi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

URDHËR**Nr. 97, datë 13.7.2023****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Brendshëm, z. Andi Mahila, për datën 14.7.2023.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm, z. Andi Mahila.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi**

URDHËR**Nr. 412, datë 11.7.2023****PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË
LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE,
NËNPRODUKTEVE TË TYRE,
MATERIALIT BIOLOGJIK,
EMBRIONEVE, MISHIT DHE
NËNPRODUKTEVE TË TYRE
NGA LITUANIA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, e Kushtetutës, neni 42 dhe 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve e kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga shteti i Lituanië:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Alytaus	Alytaus	
Kauno	Kėdainių	
Kauno	Kauno	
Kauno	Kaišiadoryų	
Kauno	Prienų	
Kauno	Jonavos	
Klaipėdos	Kretingos	
Klaipėdos	Skuodo	
Klaipėdos	Šilutės	



Marijampoles		
Šiauliai	Akmenės	
Šiauliai	Šiaulių	
Taurages	Tauragės	
Taurages	Jurbarko	
Telšiai	Telšių	
Telšiai	Plungės	
Utenos	Anykščiu	
Utenos	Molėtų	
Utenos	Zarasų	
Utenos	Utenos	
Utenos	Ignalinos	
Utenos	Zarasų	
Vilniaus	Šalčininkų	
Vilniaus	Ukmergės	

1.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave ; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

1.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e

përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

1.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

1.4. Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.



1.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vlarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

1.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Urdhri nr. 557, datë 22.11.2022, “Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga, Lituania”, shfuqizohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdher hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca



URDHËR
Nr. 413, datë 11.7.2023

PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË
LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE,
NËNPRODUKTEVE TË TYRE,
MATERIALIT BIOLOGJIK,
EMBRIONEVE, MISHIT DHE
NËNPRODUKTEVE TË TYRE
NGA GREQIA

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 42 dhe 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga shteti i Greqisë:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	*Ndarja administrative e nivelit të tretë
Macedonia and Thrace	Central Macedonia*	
Epirus and Western Macedonia	West Macedonia*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar.*

1.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtagjës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të murtagjës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

1.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtagjës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtagjës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

1.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtagjës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtagjës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.



1.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenin 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërtetohet se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

d) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

1.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenin 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në

mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Urdhri nr. 377, datë 22.6.2023, “Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit



dhe nënprodukteve të tyre nga Greqia”, shfuqizohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 414, datë 11.7.2023

**PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË
LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE,
NËNPRODUKTEVE TË TYRE,
MATERIALIT BIOLOGJIK,
EMBRIONEVE, MISHIT DHE
NËNPRODUKTEVE TË TYRE NGA
BOSNJË-HERCEGOVINA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 42 dhe 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve e kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre, të kafshëve të llojit derra vetëm nëse plotësohen

kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga shteti i Bosnjë-Hercegovinës:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Republika Srpska	Bijeljina	Bijeljina*
Republika Srpska	Doboj	Šamac*

1.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

1.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përpunje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përpunje me kapitujt 4.6 dhe 4.7, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përpunje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

1.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një



stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

1.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

1.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të nenëve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose



b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 415, datë 11.7.2023

**PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË
LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE,
NËNPRODUKTEVE TË TYRE,
MATERIALIT BIOLOGJIK,
EMBRIONEVE, MISHIT DHE
NËNPRODUKTEVE TË TYRE
NGA KROACIA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 42 dhe 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011,

“Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Lejimin e importit dhe transitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve e kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga shteti i Kroacisë:

<i>Ndarja administrative e nivelit të parë</i>	<i>Ndarja administrative e nivelit të dytë</i>	<i>Ndarja administrative e nivelit të tretë</i>
Vukovarsko-Srijemska*		
Brodsko-Posavska	Sikirevci*	

1.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

1.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenin 15.1.28 deri më 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;



c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

1.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri më 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

1.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet, që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajes afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me

rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

1.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet, që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

1.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet, që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

1.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet, që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajes afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe



janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet, që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

3. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR

Nr. 416, datë 12.7.2023

PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE, NËNPRODUKTEVE TË TYRE, MATERIALIT BIOLOGJIK, EMBRIONEVE, MISHIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NGA MAQEDONIA E VERIUT

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 42 dhe 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga shteti i Maqedonisë së Veriut:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Češinovo-Obleševo	Ularci*	
Delcevo*		
Karbinci	Karbinci*	
Kočani	Obleshevo*	
Kočani	Trkanje*	
Kočani	Mojanci*	
Kočani	Dolni Podlog*	
Kratovo*		
Gostivar*		
Kriva Palanka	Kriva Palanka*	
Kumanovo	Kumanovo*	
Kumanovo	Dolno Konjare*	
Kumanovo	Ljubodrag*	
Kumanovo	Tabanovce*	
Kumanovo	Recica*	
Makedonska Kamenica	Moshtica*	
Makedonska Kamenica	Preseka*	
Makedonska Kamenica	Glavovica*	
Novo Selo	Novo Selo	



Probištip	Drenok*	
Probištip	Shtalkovica*	
Probištip	Stalkovica*	
Rankovce	Otosnica*	
Staro Nagoriçane	Staro Nagoriçane*	
Staro Nagoriçane	Arbanasko*	
Staro Nagoriçane	Tromegja*	
Štip	Štip*	
Vinitsa	Vinitsa*	
Vinitsa	Vinicka Krshla*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

1.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

1.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

1.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

1.4. Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.



1.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vlarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

1.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar, për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Urdhri nr. 303, datë 17.5.2023, “Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Maqedonia e Veriut”, shfuqizohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdher hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca



URDHËR

Nr. 447, datë 11.7.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Kulturës, zëvendësministrit të Ministrisë së Kulturës, znj. Meri Kumbe, nga data 13.7.2023 dhe datë 14.7.2023.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Kulturës, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Kulturës dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit;

b) ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Kulturës.

3. Në ushtrimin e kompetencave, sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës ose personi që ushtron detyrat e tij në rast mungese.

4. Zëvendësministri ndalohej të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

5. Ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Kulturës, znj. Meri Kumbe, për zbatimin e këtij urdhri.

6. Ngarkohet Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve për komunikimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS

Elva Margariti

VENDIM

Nr. 194, datë 19.6.2023

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MAJ 2023 PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1732/1 prot., datë 9.6.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 4357 prot., datë 1.6.2023, protokolluar me tonën me nr. 1732 prot., datë 5.6.2023, shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin maj 2023, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Referuar kërkesës së sipërcituar të FSHU sh.a. vihet re, se shoqëria vijon të përfshijë ndër të tjera edhe kostot e imbalancave në përllogaritjen e çmimit (zë i emërtuar nga shoqëria si disbalanca). ERE, sikurse referuar edhe shkresës nr. 2030/1 prot., datë 14.12.2022, në mënyrë të përsëritur ka sqaruar shoqërinë, se bazuar në nenin 6, pika 3 dhe pika 5 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e



energjisë elektrike për këta klientë, për periudhën e livrimit. Mbi këtë tarifë do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga Rregullatori. Sikurse përcaktohet në metodologji, kostot e imbalancave do të llogariten dhe do të faturohen në përputhje me përcaktimet e rregullave të tregut dhe akteve të tjera në fuqi.

- Mbështetur në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2023 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022, të Bordit të ERE-s, kostot

administrative të përlogaritura për aktivitetin e furnizimit vijnë të mbeten në vlerën 1.06 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 324, datë 14.12.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2023, përlogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin maj 2023</i>		
	Njësia	Çmimi
CBEt ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	12.57
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.38
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA		Leke/kWh 16.41

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 16.41 lekë/kWh për muajin maj 2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin maj 2023, prej 16.41 lekësh/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 195, datë 19.6.2023****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “EU
GREEN ENERGY” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 10, pikave 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1271/4 prot., datë 16.6.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EU Green Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “EU Green Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1271 prot., datë 18.4.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. ERE, me e-mail-in e datës 26.4.2023, i evidentoi shoqërisë gjetjet e saj pas dorëzimit të aplikimit dhe dokumentacionin plotësues që duhet të përcillte në kuadër të aplikimit. Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1271/2 prot., datë 2.5.2023, depozitoi dokumentacion plotësues për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u evidentua se shoqëria nuk ishte e qartë, për këtë arsye më datë 5.6.2023, ERE zhvilloi një seancë dëgjimore me shoqërinë. Në vijim të seancës dëgjimore, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1273 prot., datë 6.5.2023, paraqiti dokumentacion plotësues për aplikimin.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin,

transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “EU Green Energy” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, për pikën 1.1, ghermat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, ghermat “a”, “c” dhe “d” dhe për pikën 1.3, ghermën “a”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion mbështetës të financimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj.

- Germa “c”: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE planin e biznesit të dedikuar për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Pika 2.5. Shoqëria duhet të nënshkruajë dhe/ose të vulosë dokumentin mbi sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EU Green Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 196, datë 19.6.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV
BLUE 1” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d”, dhe nenit 10, pikave 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1757/2 prot., datë 16.6.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1757 prot., datë 7.6.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi, për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisjen me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germën “a” dhe për pikën 2.4, germat “a”, “c” dhe “d”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ:

- Germa “a”: Shoqëria duhet të përfshijë në objektin e saj dhe veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Germa “b”: Duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion mbështetës të financimit të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj.

- Germa “c”: Plani i biznesit i depozituar i referohet vetëm veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaiik “Blue 1”, por referuar kërkesave specifike të kësaj pike të rregullores shoqëria duhet të depozitojë në ERE planin e biznesit për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.



Pika 2.4. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të bëjë me dije se kur do të jetë funksional sistemi SKADA dhe po ashtu nëse ky sistem mbulon dhe realizimin e procesit të faturimit të klientëve.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 197, datë 19.6.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin,

rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1756/4 prot., datë 16.6.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1756 prot., datë 7.6.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germën “a” dhe pikën 2.5.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Pika 1.2, dokumentacioni juridik dhe administrativ:



- germa “b”: duhet të depozitohet në ERE vërtetimi i gjendjes gjyqësore lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k.

Pika 1.3, dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “b”: shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion mbështetës të financimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj;

- germa “c”: plani i biznesit i depozituar, i referohet vetëm veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltai “Blue 1”, por referuar kërkesave specifike të kësaj pike të rregullores shoqëria duhet të depozitojë në ERE planin e biznesit për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 198, datë 19.6.2023

MBI SHTYRJEN E AFATIT TË PARASHIKUAR NË KONTRATËN PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SHA

Ne mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Teknike me nr. 1748/2 prot., datë 16.6.2023, “Mbi pezullimin e zbatimit të afatit të parashikuar në kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtureshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 343, datë 21.12.2022”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 257, datë 21.12.2020, ka miratuar programin e pajtureshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., ndërsa me vendimin nr. 343, datë 21.12.2022, Bordi i ERE-s ka miratuar “Kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtureshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.”, ku në pikën 3.1.1 të saj përcaktohet se: “Zyrtari ka për detyrë, ndër të tjera dhe hartimin e një raporti vjetor, ku përcaktohen masat e marra për zbatimin e programit dhe dorëzimin e këtij raporti në ERE dhe te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 114, datë 27.3.2023, ka miratuar emërimin e z. Ervis Hazizi, si Zyrtar i Pajtureshmërisë (ZP), të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe për arsye të sqarimit të ZP-së mbi mënyrën e përgatitjes së raportit, meqenëse është raportimi i parë për z. Hazizi, në ERE, më datë 12.6.2023, u mbajt një seancë dëgjimore me praninë e z. Hazizi, përfaqësues të OSSH sh.a. dhe përfaqësues të ERE-s.



- Zyrtari i Pajtuëshmërisë deklaroi se ka nisur puna për mbledhjen e të gjithë informacionit të nevojshëm për të përgatitur raportin, i cili do të depozitohet në ERE brenda 1 muaji, pra brenda datës 12.7.2023.

- Për gjithë sa u argumentua, vlerësohet të shtyhet zbatimi i afatit të parashikuar në pikën 3.1.1, të “Kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.”, deri jo më vonë se data 12.7.2023. Kjo shtyrje afati vlen vetëm për dorëzimin e raportit vjetor të pajtuëshmërisë për vitin 2022.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë afatin e parashikuar në pikën 3.1.1, të “Kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.”, jo më vonë se data 12.7.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë Zyrtarin e Pajtuëshmërisë së shoqërisë OSSH sh.a. dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 207, datë 27.6.2023

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 63, DATË 8.4.2020, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘GEGA-G’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘PREVALLI’ ME KAPACITET TË INSTALUAR 1750 kw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1753/2 prot., datë 22.6.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63, datë 8.4.2020 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Gega-G’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Prevalli’ me kapacitet të instaluar 1750 kw dhe disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s 64, datë 8.4.2020 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Gega-G’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 63, datë 8.4.2020, ka vendosur:

“1. Të licencojë shoqërinë “Gega-G” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Prevalli” me kapacitet të instaluar 1750 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria të depozitojë në ERE tre muaj para përfundimit të afatit të saj, kontratën e qirasë për truallin ku do të ushtrohet veprimtaria, të rinovuar.

3. Shoqëria të depozitojë në ERE lejen “Për përdorimin të burimit ujor”, të rinovuar, jo më vonë se data 16.12.2022.

4. Shoqëria në përfundim të procesit gjyqësor me objekt shfuqizimin e Aktit Administrativ “Njoftim vlerësimi për detyrimet” nr. 7647/7



prot., datë 29.3.2016, të depozitohet në ERE vendimin përfundimtar të gjykatës.

5. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.”.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 2, *depozitimin në ERE 3 (tre) muaj para përfundimit të afatit të saj, kontratën e qirasë për truallin*, rezulton se shoqëria ka aktualisht një kontratë të vlefshme qiraje, deri më 4.10.2027, si të tillë në vijim brenda afatit të sipërcituar (4.10.2027), vlerësohet që shoqëria të depozitohet të rinovuar këtë dokument. Për këtë qëllim kjo pikë ndryshohet, duke i lënë detyrë shoqërisë që të depozitohet në ERE kontratën e rinovuar të qirasë të lidhur me Bashkinë Librazhd brenda datës 4.10.2027, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në territorin ku shtrihet projekti i HEC “Prevalli”.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3, të depozitimit në ERE të lejes për përdorimin të burimit ujor, të rinovuar, në vijim të korrespondencës së zhvilluar me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) dhe vetë shoqërinë në lidhje me procesin e rinovimit të kësaj lejeje, rezulton se me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1753/1 prot., datë 20.6.2023, shoqëria ka depozituar në ERE, vendimin nr. 2 datë 6.10.2022, të Këshillit të Basenit Ujor (KBU) Shkumbin për miratimin e rinovimit të lejes së përdorimit të burimit ujor, si dhe lejen përkatëse të miratuar me këtë vendim, me afat vlefshmërie 5 vjet.

- Duke qenë se afati i vlefshmërisë së kësaj lejeje, referuar Regjistrin të lejeve/autorizimeve për përdorim burimi ujor për prodhim hidroenergje të AMBU-së, është deri më datë 6.10.2027, vlerësohet ndryshimi i pikës 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 63/2020, duke i lënë detyrë shoqërisë që të depozitohet në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergje nga HEC “Prevalli” jo më vonë se data 6.10.2027.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 4, të depozitimit në ERE të vendimit përfundimtar të gjykatës lidhur me shfuqizimin e Aktit Administrativ Njoftim vlerësimi për detyrimet nr. 7647/7 prot., datë 29.3.2016, rezulton se, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1753/1 prot., datë 20.6.2023, shoqëria ka depozituar vendimin nr. 596, datë 7.12.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit, ku është vendosur

shfuqizimi i aktit administrativ “Njoftim vlerësimi për detyrimet nr. 7647/7 prot, datë 29.3.2016”. Me depozitimin e këtij vendimi, rezulton se është plotësuar ky kusht, ndaj si i tillë vlerësohet të shfuqizohet.

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 63, datë 8.4.2020, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria “Gega-G” sh.p.k. të depozitohet në ERE kontratën e rinovuar të qirasë të lidhur me Bashkinë Librazhd brenda datës 4.10.2027, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në territorin ku shtrihet projekti i HEC “Prevalli”.”.

2. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 63, datë 8.4.2020, ndryshon dhe bëhet:

“3. Shoqëria “GEGA-G” sh.p.k. të depozitohet në ERE lejen e rinovuar për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergje nga HEC Prevalli jo më vonë se data 6.10.2027.”.

3. Pika 4 vendimit të Bordit të ERE-s nr. 63, datë 8.4.2020, shfuqizohet.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Gega-G” sh.p.k., Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 210, datë 27.6.2023

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 249, DATË
13.12.2021, I NDRYSHUAR, NË LIDHJE
ME PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË
LICENCIMIT NGA SHOQËRIA “E-
VENTO S.R.L ALBANIA” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 2, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 78/14 prot., datë 26.6.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 249, datë 13.12.2021, i ndryshuar, në lidhje me plotësimin e kushteve të licencimit nga shoqëria ‘E-Vento s.r.l Albania’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

Në kuptim të vendimeve të Bordit të ERE-s nr. 249, datë 13.12.2021, i ndryshuar, me vendimet nr. 269, datë 14.10.2022, dhe nr. 357, datë 30.12.2022, shoqëria “E-Vento S.R.L Albania” sh.p.k., ka detyrimin:

1. Të depozitojë në ERE brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve (studimin e fisibilitetit).

2. Brenda 3 (tre) muajve të depozitimit deklarantë mjedisore dhe brenda 6 (gjashtë) muajve të depozitimit dokumentacionin pronësor duke filluar ky afat nga data 15.12.2022.

3. Çdo 3 (tre) muaj të dokumentojë në ERE një progres raport me informacion për investimet që do të kryejë, në kuadër të plotësimit të kushteve të sipërcituara.

- Ky vendim në përputhje me informacionin/ dokumentacionin e përditësuar apo aktet ligjore apo nënligjore të dala nga organet e tjera është objekt rishikimi nga ERE.

- Në vijim të korrespondencës me shoqërinë në lidhje me plotësimin e kushteve të vendosura në vendimin e sipërcituar (me shkresat nr. 78 prot., datë 11.1.2023, nr. 78/1 prot., datë 12.1.2023, nr.

78/2 prot., datë 27.1.2023, nr. 78/3 prot., datë 27.1.2023, nr. 78/4 prot., datë 13.3.2023, nr. 78/5 prot., datë 20.3.2023) dhe me qëllim sqarimin e rrethanave që kanë ndikuar që shoqëria të mos plotësojë në afat kushtet e vendimit nr. 249/2021, i ndryshuar, ERE njoftoi shoqërinë me shkresën nr. 78/7 prot., datë 30.3.2023 për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 7.4.2023. Shoqëria nuk mundi të merrte pjesë, por në të njëjtën ditë, me shkresën nr. 78/8 prot., datë 7.4.2023, depozitoi në ERE informacion dhe dokumentacion në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimit të sipërcituar.

- Në lidhje me kushtin që ka të bëjë me depozitimin e studimit të fisibilitetit, shoqëria ka informuar ERE-n në vijimësi dhe ka dokumentuar përpjekjet e saj për realizimin e këtij studimi, duke depozituar dhe në ERE në anglisht studimin e prefizibilitetit të kryer nga shoqëria e kontraktuar, për të cilin ka bërë me dije se është në fazën e finalizimit. Në këto rrethana bazuar në kërkesën e shoqërisë për shtyrje të afatit vlerësohet që të shtyhet deri më datë me 31.12.2023 afati i depozitimit të studimit të fizibilitetit.

- Shoqëria ka depozitar ERE deklaratës mjedisore, duke plotësuar pjesërisht kushtin e vendosur në pikën 2. Po ashtu, me depozitimin e dokumentacionit pronësor të zonës ku do të shtrihet projekti eolik, shoqëria ka argumentuar se është bërë azhurnimi i parcelave pyjore dhe materiali i ka kaluar bashkive përkatëse për nënshkrim dhe kjo do të bëhet nga kryetarët e zgjedhur rishtazi të bashkive përkatëse. Në këto rrethana, duke marrë në konsideratë përpjekjet e saj dhe faktin që finalizimi i këtij dokumentacioni nuk varet i tëri nga vullneti i shoqërisë, vlerësohet të merret në konsideratë kërkesa e saj dhe të shtyhet deri më 31.12.2023 afati për depozitimin e dokumentacioni pronësor.

- Në lidhje me kushtin që ka të bëjë me depozitimin e një progres raporti çdo 3 (tre) muaj me informacion për investimet që do të kryejë, në kuadër të plotësimit të kushteve të sipërcituara, rezulton se shoqëria ka depozituar në mënyrë të vazhdueshme dokumentacion dhe informacion në lidhje me ecurinë e saj për realizimin e studimit të fizibilitetit dhe për pajisjen me dokumentacion pronësor në kuadër të realizimit të projektit eolik.

- Gjithashtu në kuadër të raportimit dhe të plotësimit të kushtit të lënë në vendimin e Bordit nr. 269/2022, sipas të cilit shoqëria duhet të



paraqesë në mënyrë periodike në ERE, me data të rifreskuara, dokumentet që i nënshtrohen rinovimit të afateve, rezulton se shoqëria i është drejtuar me disa shkresa të njëpasnjëshme “Operatorit të Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. (shkresa e fundit e datës 1.6.2023), me anë të të cilave i ka kërkuar miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes dhe nënshkrimin e aktmarrëveshjes. Nga ana e OST-së sh.a. nuk ka ende një kthim përgjigjeje.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 249, datë 13.12.2021, ndryshon si vijon:

“1. Shoqëria, deri më 31.12.2023, të depozitojë në ERE studimin e fisibilitetit.”.

2. Pika 2 e vendimit nr. 249, datë 13.12.2021, ndryshon si vijon:

“2. Shoqëria, deri më datë 31.12.2023, të depozitojë në ERE dokumentacionin pronësor.”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 211, datë 27.6.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 250, DATË 13.12.2021, TË NDRYSHUAR, NË LIDHJE ME PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË LICENCIMIT NGA SHOQËRIA “SOT-AL” SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 53, pika 2, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 962/4 prot., datë 26.6.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 250, datë 13.12.2021, të ndryshuar, në lidhje me plotësimin e kushteve të licencimit nga shoqëria ‘SOT-AL’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

Në kuptim të vendimeve të Bordit të ERE-s nr. 250, datë 13.12.2021, i ndryshuar dhe nr. 268, datë 14.10.2022, shoqëria “SOT-AL” sh.p.k., ka detyrimin:

1. Të depozitojë në ERE brenda 3 (tre) muajve miratimin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale,

2. Brenda 6 (gjashtë) muajve të depozitojë në ERE dokumentacionin pronësor, duke filluar ky afat nga data 14.9.2022.

3. Çdo 3 (tre) muaj të dokumentojë në ERE një progresraport me informacion për investimet që do të kryejë, në kuadër të plotësimit të kushteve të sipërcituara.

4. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë në përputhje me informacionin/dokumentacionin e përditësuar sipas pikës 2 të këtij vendimi, apo aktet ligjore apo nënligjore të dala nga organet kompetente.

- Po ashtu, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 268, datë 14.10.2022, shoqërisë i është lënë detyrë që të paraqesë në ERE, në mënyrë periodike, me



data të rifreskuara dokumentet që i nënshtrohen rinovimit të afateve.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë dhe seancës dëgjimore të mbajtur më datë 6.4.2023, në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 1, të vendimit nr. 250/2021, për depozitim në ERE të miratimit nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale shoqëria ka sqaruar se Deklarata Mjedisore ka kufizuar praktikisht shtrirjen e zonës së projektit, ndaj është bërë e nevojshme që të ndërmerret një studim i ri. Kjo situatë kushtëzon marrjen e dokumentacionit pronësor, sepse do të sjellë zvogëlimin e sipërfaqes ku shtrihet projekti, kryerjen e studimit arkeologjik dhe procedimin për marrjen e miratimit të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Materiale.

- Shoqëria ka kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 250/2021, të ndryshuar, me 12–18 muaj.

- Duke qenë se procedurat për t'u pajisur me këto dokumente, që janë objekt i kushteve të vendimarrjes së ERE-s nr. 250/2021, i ndryshuar, janë të ndërthurura me njëra-tjetrën dhe nuk varen vetëm nga vullneti i shoqërisë, pasi studimi i fizibilitetit duhet të ndiqet nga përditësimi i zonës ku do të shtrihet projekti dhe duhet të ndiqen procedurat në organet/institucionet kompetente të nivelit qendror ose lokal, sipas procedurave përkatëse, kërkesa për shtyrje vlerësohet e arsyeshme.

- Për gjithë sa më sipër, duke marrë në konsideratë angazhimin e shoqërisë për plotësimin e kushteve të vendimit nr. 250/2021, i ndryshuar, dhe po ashtu sa argumentuar nga ana e saj se për të plotësuar kushtet e vendimit nr. 250/2021, i ndryshuar, duhet të bëhet fillimisht një studim i ri fizibiliteti, vlerësohet t'i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE brenda datës 30.6.2024 dhe brenda datës 31.12.2024 miratimin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe dokumentacionin pronësor.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës

së Shqipërisë”, parashikohet se: “Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 250, datë 13.12.2021, i ndryshuar, ndryshon si vijon:

1. Shoqëria “SOT-AL” sh.p.k. të depozitojë në ERE:

a) Studimin e ri të fizibilitetit brenda datës 30.6.2024;

b) Miratimin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe dokumentacionin pronësor brenda datës 31.12.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë